



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta / Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref. Nr.	1676/2018
Data / Datum / Date	23.05.2018
nënshkrim / Eptis / Signature	<i>A. Dojleu</i>
PRISHTINË, PRISTINA/PRISHTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

23.05.2018, Prishtinë

FTESË PËR APLIKIM PËR ANËTARË TË KOMISIONIT VLERËSUES
PËR PROJEKTET PËR NDËRMJETËSIM NË PUNË

Bazuar në Rregulloren e MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të si dhe bazuar në Vendimin nr. 677 të datës, 08.05.2018 të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për thirrjen publike për mbështetje financiare publike për projekte/ programe të organizatave jo-qeveritare në fushën e Punësimit të rinjve, ftojme Organizatat Jo Qeveritare/shoqërinë civile, të aplikojnë për të marr pjesë në komisionin e vlerësimit të projekteve për Ndërmjetësim në punë, në cilësinë:

- Përfaqësues nga OJQ-të (një anëtar)
- Përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit (një anëtar)

Përfaqësuesit e lartcekur, do të jenë anëtarë të Komisionit vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve për shkathtësi të buta, të pranuar nga organizatat jo qeveritare (OJQ) sipas thirrjes publike të shpallur me datë 10.05.2018.

Të interesuari për aplikim për anëtar të komisionit duhet t'i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të Ftesës Publike:

1. Përvojë në përgatitjen dhe / ose zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike;
2. Përvojë në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike;
3. Njohja e dokumenteve strategjike dhe politikave prioritare në fushën e Rinisë;
4. Njohja e bazës ligjore në fuqi në fushat që mbulon Ftesa Publike;

5. Njohja e metodologjive ekzistuese sektoriale në fushën e punësimit të të rinjve;
6. Njohja e dokumenteve të tjera relevante në fushën në të cilën është hapur Ftesa Publike;
7. Njohja e përgjithshme e punës së MKRS/DiR si dhe njohuri në fushat në të cilat është hapur Ftesa Publike.

Afati për aplikim është deri me datë, **01.06.2018**. CV duhet të dërgohen në e-mail adresën si vijon: burim.mexhuani@rks-gov.net dhe të shkruhet në **subjekt pozitën për anëtar të komisionit për të cilin aplikoni**.